

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - MALLRA**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Blerje\_Sonda per Eko Abdominale Mindray DC-N2” per QShS Nr.4”**

**REF-03603-05-02-2024**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

**33100000-1 Pajisje Mjekesore**

VLERA E FONDIT LIMIT:

**Fondi Limit: : 2,442,000 (dy milion e kater qind e dyzet e dy mije ) leke pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

## **1. Të jetë i regjistruar në QKR**

### **2. Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij objektin që prokurohet**

AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë certifikatën në fjale.

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore.**

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi *“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”*, me objekt aktiviteti të certifikatës për tregtim të paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

c) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 13485:2016** mbi *“Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”*, me objekt aktiviteti të certifikatës për tregtim të paisjeve mjekësore në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

**AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit dhe në rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet të paraqesë certifikatën në fjale.**

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlera e tyre të jete **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.**

Nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme, **jo më e vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
  - a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për permbushjen me sukses të kontratës, ku të shihen vlerat. Afati i perfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
  - b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë Certifikatën konformiteti CE, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre, të përkthyer dhe të noterizuar.

**Argumentimi:** Në bazë të nenit të 77 pika 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar

3. Kompania prodhuese të jetë e certifikuar me **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose **ISO 13485:2016** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, pika 3,4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë Certifikatat përkatëse që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën /shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislativi në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

4. Operatori Ekonomik Ofertues duhet të vërtetojë që ka të paktën 2(dy)\* Inxhinier/Specialist në stafin e tij të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e furnizimit - vendosjes së pajisjes objekt prokurimi si dhe riparimin apo ndrrimin e pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankesave, të gjithë

dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpageswn e shoqërisë për muajin e fundit për vetëdeklarimet mbi punonjësin e kërkuar në DST.

**Argumentimi:** Kërkesa është hartuar në përputhje me pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 paragrafet b dhe c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij.  
Konkretisht:

VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit...”, si dhe pika 8 “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës i referohet pikës 1 dhe pikës 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021.

Kërkesa e autoritetit kontraktor për 2(dy)\* Inxhinier/Specialist në stafin e tij të trajnuar për pajisjet mjekësore të cilët do të kryejnë shërbimin e furnizim - vendosjes së pajisjes objekt prokurimi si dhe riparimin apo ndrrimin e pjesëve të këmbimit, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, çertifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës pasi do te jete pergjegjes per

instalim, trajnim te stafit mjeksore, lidhet me domosdoshmërinë për prezencën në stafin e OE, do të siguronte që çdo pikë e kërkesave të AK të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të dokumentave të tenderit.

**5.** Ofertuesit duhet te dorëzojnë mostra për te gjitha artikujt e shënuar me shënjën (\*) në tabelën përkatëse. Mostrat të dorëzohen pranë Komisionit të Vlerimit të Ofertave, në QSHS NR.4, të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet: Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerimit të Ofertave, të procedurës së prokurimit me objekt:

Dorëzimi i mostrave të bëhet pranë Qendres Shendetesore te Specialiteteve Paskuqan, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: *“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerimit te Ofertave te procedurës se prokurimit per kete objekt prokurimi dhe jo para datës se vleresimit te ofertave*

- *Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 2).*
- *Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 2).*

*Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, e cila dorëzohet vetëm elektronikisht. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.*

**Argumentimi:** *Ky kriter është vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qëllim vërtetimin se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale në përputhje me nenin 40, pika 6 b) të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar më mire mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të kërkuara për objektet që prokurohen me qëllim që cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga AK.

**Shënim:** KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

**1. Sondat duhet të jene te pershtatshme per Aparturen EKO Abdominale Model MINDRAY DC-N2 qe disponon QSHS Nr.4**

**2. Operatori ekonomik duhet te paraqese cer ISO 9001-2015 si dhe ISO 13485 :2016.**

**3. Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi ose Dristrubitori per Artikujt.**

**4. Garancia e artikujve duhet te jete te pakten 24 muaj nga momenti I instalimit te pajisjeve.**

**5. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për tregtimin të pajisjeve mjekësore.**

**6. Ofertuesit duhet te dorezojne mostra per te gjitha artikujt e shënuar me shënjën (\*) në tabelën përkatëse. Mostrat të dorëzohen pranë Komisionit të Vlersimit të Ofertave, në QSHS Nr.4, të mbyllura në një zarf/kuti jo transparente të vulosur mbi të cilin të shënohet: Mos e hapni me perjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlersimit të Ofertave, të procedurës së prokurimit me objekt.**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi mallit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1*	Sonde Konvekse abdominale per Mindray ose ekuivalente	copë	1
2*	Sonde Lineare per Mindray ose ekuivalente	copë	1
3	Perditesim I software per Mindray ose ekuivalente	copë	1

4*	Board I amplifikimit te sinjalit per Mindray ose ekuivalente	copë	1
5	HDD I njesise llogjike per Mindray ose ekuivalente	copë	1

**Garancia e artikujve duhet te jete te pakten 24 muaj nga momenti I instalimit te pajisjeve.**

**Afatet e lëvrimnit: 10 dite nga lidhja e kontrates me operatorin fitues.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*